



**REPUBLIKA SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

D E K R E T

PËR

**KTHIMIN E LIGJIT NR. 39/2018 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”.**

Në mbështetje të neneve 85, pika 1 dhe 93, të Kushtetutës,

D e k r e t o j

Kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, me qëllim rishqyrtimin e nenit 6 të këtij ligji.

**Nr. Dekretit 10850
Tiranë, më 30.07.2018**

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

ILIR META

Arsyet e kthimit të ligjit nr. 39/2018

“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, me qëllim rishikimin e nenit 6 të këtij ligji

Të nderuar deputetë,

Në seancën plenare të datës 9 korrik 2018, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Ky ligj i është dërguar Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje në datën 11 korrik 2018.

Sipas relacionit të Këshillit të Ministrave dhe Raportit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, ndryshimet e propozuara në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, vijnë në kuadër të realizimit të nismës së qeverisë për implementimin e një pakete të re fiskale me qëllim dhënien e mbështetjes së vazhdueshme për sipërmarrjen private dhe garantimin e rritjes së qëndrueshme të tyre, gjë e cila prodhon punësim. Ligji nr.39/2018, i miratuar nga Kuvendi përmban gjithësej 8 dispozita, të cilat kryesisht prodhojnë lehtësira fiskale për disa sektorë të ekonomisë shqiptare.

Institucioni i Presidentit të Republikës vlerësoi në tërësi dispozitat ligjit nr.39/2018, duke kryer një analizë të efekteve pozitive që sjell aplikimi i lehtësirave fiskale në degë të caktuara të ekonomisë.

Nga studimi që ju bë dispozitave të ligjit nr.39/2018, Presidenti i Republikës, vlerëson pozitivisht iniciativën e qeverisë dhe Kuvendit, për ato dispozita të ligjit të cilat synojnë reduktimin e normës së tatim fitimit nga 15% në 5%, për biznesin e vogël dhe të mesëm, për fermerët që përfshihen në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, si dhe për ato biznese që operojnë në fushën e agroturizmit.

Përveç sa më sipër, nga shqyrtimi i ligjit nr. 39/2018, konstatohet se vetëm një dispozitë e tij dhe konkretisht neni 6 i ligjit, paraqet një problematikë të theksuar, pasi parashikimet e tij realizojnë uljen e barrës fiskale, për bizneset që operojnë sot në të gjitha kategoritë e lojërave të fatit.

Për arsyet që do të shpjegohen më poshtë, neni 6 i ligjit nr. 39/2018, duhet të vlerësohet edhe një herë nga Kuvendi, në mënyrë që kjo paketë fiskale të realizohet në atë mënyrë që të jetë tërësisht në interes të publikut dhe ekonomisë, duke mbështetur rritjen e mirëqënies familjare, dhe aspak cënimin e saj.

Duke krahasuar efektet pozitive që vijnë nga zbatimi i barrës së lehtësuar fiskale ndaj operatorëve dhe bizneseve në fushën e lojërave të fatit, përkundrejt dramave sociale dhe konflikteve në familje që janë shkaktuar në vijimësi nga pjesëmarrja në lojrat e fatit, **arrihet në konkluzionin se iniciativa propozuese për të lehtësuar barrën fiskale përkundrejt bizneseve të lojërave të fatit, nuk është vlerësuar në mënyrë të thelluar nga qeveria dhe Kuvendi. Në aktet që shoqërojnë këtë propozim ligjor, nuk ekziston asnjë argument në këtë drejtim.**

Gjithashtu në përfundim të vlerësimit të nenit 6, të ligjit nr.39/2018, arrihet në konkluzionin se mbështetja e bizneseve në fushën e lojrave të fatit për gjithë kategoritë e tyre, përbën pengesë serioze për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Prezenca dhe përhapja në territor i shumë biznesve në këtë sektor, rrit aksesin e qytetarëve ndaj lojrave të fatit dhe mundësinë e pjesëmarrjes në to, duke e keqorientuar individin për sigurimin e jetesës dhe nevojave të tij të përditshme, përmes aktiviteteve jo produktive.

Varësia e individit ndaj lojrave të fatit, krijon premisë për përkeqësimin e gjendjes ekonomike dhe nxit konfliktin brenda familjes, me pasoja të rënda shëndetësore dhe sociale. Relacionet që mbështesin propozimin e nenit 6 të ligjit nr.39/2018, nuk trajtojnë këto aspekte të rëndësishme, të cilat duhet të ishin vlerësuar me shumë kujdes dhe seriozitet nga qeveria dhe Kuvendi.

Bazuar në sa më sipër, në bindje të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të saj, Presidenti i Republikës, vlerëson se neni 6 i ligjit nr.39/2018, nuk është në përputhje me objektivat social të shtetit Shqiptar të përcakuar në nenin 59 të Kushtetutës, i paargumentuar nga ana ekonomike, dhe për këto arsye, ky ligj i duhet kthyer Kuvendit, me qëllim rishikimin e këtij neni.

1. **Së pari**, ndryshimet e realizuara në nenin 6, të ligjit nr. 39/2018, janë të pa argumentuara dhe nga vlerësimi i tyre rezulton se, zbatimi i këtij neni do të sjell përfitim vetëm në favor të bizneseve që operojnë në fushën e lojrave të fatit, ndërkohë efektet e pritshme në buxhet apo në ekonominë familjare janë negative.

Neni 6, i ligjit nr.39/2018 të miratuar nga Kuvendi, parashikon ndryshimin e paragrafit të dytë, të pikës 7, të nenit 38, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me këtë përmbajtje:

“Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit nr.155/5015,” Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15% mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjithë kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licensuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojëtarët në lojërat e fatit dhe shumë së fituar prej tyre. Tatimin mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Për të arritur në një konkluzion të qartë se çfarë ndryshohet realisht nëpërmjet këtij ligji është e nevojshme të evidentohet dispozita aktuale në fuqi, e cila sot, ka këtë përmbajtje:

“Të ardhurat e organizatorëve të lojërave të fatit taten me tarifën tatimore mbi të ardhurat bruto, sipas kuptimit dhe përcaktimit në ligjet respektive të fushës, ligjit nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 95/2013 “Për miratimin e marrëveshjes së licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k.”.

Referuar përmbajtjes së dispozitës të ndryshuar rezulton se, industria e lojrave të fatit sipas nenit 6 të ligjit nr.39/2018, përfiton drejtpërdrejtë reduktim të barrës fiskale.

Ky reduktim realizohet nëpërmjet aplikimit të sistemit të ri të tatimit për këto biznese, i cili me ligjin e ri përcakton si të ardhura bruto, jo “xhiron totale” (siç parashikohet nga ligji ekzistues), por “fitimet bruto”, e cila përllogaritet duke zbritur shumën e fituar nga lojtarët nga shuma totale e luajtur prej tyre. **Pra sipas nenit 6 të ligjit nr. 39 /2018, barra fiskale e tatimit ulet nga 15% mbi xhiron, në 15% mbi fitimet bruto.**

Për më tepër, aktualisht industria e lojrave të fatit ka një trajtim fiskal favorizues, sepse sipas ligjit në fuqi ndaj aktivitetit të lojërave të fatit nuk aplikohet tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH), i cili është në masën 20% për shumicën dërrmuese të produkteve dhe shërbimeve.

Në relacionin e Këshillit të Ministrave që ka shoqëruar këtë nismë ligjore, por dhe në raportin e Komisionit për Ekonominë dhe Financave në Kuvend, nuk rezulton i argumentuar as impakti financiar buxhetor që do të ketë aplikimi i këtij neni. Në relacion duhej të argumentohej dhe pesha specifike e xhiros që u shpërndahet lojtarëve në lojrat e fatit, apo biletave fituese për të përllogaritur saktësisht impaktin e pritshëm negativ mbi buxhetin e shtetit.

Gjithashtu nuk rezulton të jetë arsyetuar qëllimi ekonomik i kësaj iniciative dhe nuk është trajtuar aspak çështja nëse mbështetja ndaj këtyre bizneseve nëpërmjet uljes së barrës fiskale, paraqet ose jo, risk të shtuar për zgjerim të aktivitetit të kësaj industrie dhe përhapjen e tyre masivisht në territorin e vendit, krahasuar kjo me impaktin social negativ që mund të sjellë prezenca e shtuar e këtij fenomeni në shoqëri.

Në mungesë të arsyetimit për qëllimin ekonomik dhe social të iniciativës për miratimin e nenit 6 të ligjit nr.39/2018, është qartësisht e evidentueshme që përfituesi real i këtij reduktimi fiskal është vetëm operatori/ët ekonomikë që zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën e lojrave të fatit, ndërkohë që as buxheti i shtetit, dhe as ekonomia në tërësi nuk përfitojnë nga aplikimi i këtij neni.

- 2. Së dyti, miratimi i nenit 6 të ligjit nr.39/2018, është në kundërshtim me përmbushjen e objektivave social të shtetit shqiptar, bie ndesh me frymën e legjislacionit në fuqi, në funksion të dekurajimit të aktivitetit të biznesit në industrinë e lojrave të fatit, si dhe krijon premisë për shtimin e fenomeneve negative që çënojnë familjen shqiptare.**

Në praktikën e njohur botërore të ushtrimit dhe zhvillimit të lojërave të fatit rezulton se në shumë vende të zhvilluara, sektori i lojrave të fatit, ka një regjim fiskal më të lartë se sektorët dhe industritë e tjera për vetë natyrën e biznesit të tyre. Sistemi i taksave dhe tatimeve që aplikohet ndaj lojrave të fatit në shumicën e vendeve të botës është i ngjashëm me atë që aplikohet ndaj bizneseve që prodhojnë dhe tregtojnë mallrat e lluksit të tilla si alkoli, duhani, etj.

Modeli i biznesit të lojrave të fatit nuk rezulton me vlerë të shtuar për shoqërinë, por përkundrazi zgjerimi i këtij aktiviteti në treg sjell rrezik potencial për varfërimin e ekonomisë familjare dhe krijimin e dramave sociale.

Për më tepër gjatë viteve 2015-2016, Kuvendi ka miratuar ndryshime ligjore të cilat synonin përcaktimin e një regjimi fiskal dhe rregullator më të rreptë, shtimin e barrës fiskale, me qëllim dekurajimin e këtij aktiviteti.

Një nga këto nisma ligjore ishte miratimi i legjislacionit të ri për lojrat e fatit dhe konkretisht ligji nr.155/5015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", i pasuar me ndryshime të tjera në vitin 2016 sipas këtij vullneti. **Neni 6, i ligjit nr. 39/2018, është qartazi në drejtim të kundërt me vullnetin e deritanishëm të qeverisë dhe Kuvendit të shprehur me ligj.**

Pavarësisht nga këto ndryshime ligjore të realizuara në vitin 2015-2016 dhe aksionet e ndërmarra nga qeveria në këtë drejtim, rezulton se në vitet e fundit kemi një rritje të aktivitetit dhe vëllimit të qarkullimit financiar të kësaj industrie.

Raporte të organizmave kombëtar dhe ndërkombëtar të publikuara ndër vite, kanë konstatuar se zgjerimi dhe inkurajimi i këtij modeli biznesi në industrinë e lojrave të fatit, shoqërohet dhe me fenomene dhe pasoja negative për shoqërinë dhe familjen, të tilla si:

- ***Humbje të konsiderueshme të pasurisë individuale dhe familjare, qoftë monetare, apo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme nga pjesëmarrja në lojrat e fatit;***
- ***Shtimin e rasteve të konflikteve familjare, kryesisht dhunës në familje ndaj grave dhe fëmijëve;***
- ***Rritjen e numrit të rasteve të divorceve, si pasojë e konflikteve familjare që krijohen nga humbjet financiare në lojrat e fatit, apo braktisjen e familjes ;***
- ***Shtimin e konflikteve në tërësi në shoqërinë shqiptare, dhe rritjen e konflikteve civile dhe procedimeve penale që shqyrtohen në sistemin gjyqësor;***
- ***Rritjen e numrit të të pastrehëve, si shkak i lënies peng, apo humbjes së banesës nga pjesëmarrja në lojrat e fatit;***
- ***Përkeqësim të gjendjes së shëndetit mendor, qoftë të personave pjesëmarrës në lojra fati, por dhe të familjarëve të tyre, duke sjellë në shumë raste deri në akte ekstreme të vrasjes apo vetvrasjes;***
- ***Degradimin profesional të individëve, të cilët luajnë në lojrat e fatit, duke konsumuar kohën dhe aftësitë e tyre, në aktivitete jo produktive;***
- ***Krijimin e varësisë nga lojrat e fatit tek grup moshat e reja, duke nxitur braktisjen e shkollës, përkeqësimin e nivelit të edukimit, dhe shtimit të riskut për tu angazhuar në aktivitete të paligjshme;***

Edhe pse industria e lojrave të fatit, është e lejuar me ligj, duke vlerësuar fenomenet negative të mësipërme prej të cilave vuan aktualisht shoqëria shqiptare, **Presidenti i Republikës vlerëson se, stimulimi i këtij modeli biznesi nëpërmjet një regjimi fiskal të reduktuar, është me efekt negativ për buxhetin e shtetit, i dëmshëm dhe aspak produktiv për ekonominë shqiptare, nuk mbështetet në argumente të qëndrueshme socialo-ekonomike, si dhe nuk garanton zhvillimin e shëndetshëm të shoqërisë shqiptare.**

Ndryshimet e realizuara nëpërmjet nenit 6, të ligjit nr.39/2018, nuk i përgjigjen nevojave reale të shoqërisë shqiptare dhe për më tepër ato bien ndesh me objektivat sociale të shtetit shqiptar të përcaktuara në nenin 59 të Kushtetutës.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Për arsytet e parashtruara më sipër, në bindje të Kushtetutës së Shqipërisë dhe në ushtrim të së drejtës të parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të saj, kam vendosur kthimin e ligjit nr.39/2018, për rishqyrtimin e nenit 6, nga Kuvendi i Shqipërisë.

Me qëllimin e përmirësimit të këtij ligji në frymën e ruajtjes së vlerave më të larta të shoqërisë shqiptare, kërkoj angazhimin Tuaj për rishqyrtimin e nenit 6 të ligjit nr. 39/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pasi në formën e miratuar, ky nen nuk është në përputhje me pritshmëritë e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, nuk ndihmon në prosperitetin shoqëror dhe në përmbushjen e objektivave sociale të parashikuara nga neni 59 i Kushtetutës, si dhe krijon premisa për pasoja sociale dhe ekonomike për familjen shqiptare.

Më respekt

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Ilir META